

# KADASTRA FISKALE

## BULETIN INFORMUES

Botimi 3

28 SHKURT 2022

### Përditësime mbi Sistemin Informatik të Kadastrës Fiskale

Siç është përmendur dhe më parë, ekspertët e TI të projektit ProTax së bashku me DPTP kanë punuar në vijueshmëri mbi përmirësimin e Sistemit TI të Kadastrës Fiskale. Në lidhje me këtë, është mbajtur një takim në 1 Shkurt me pjesëmarrës bashkitë dhe palët e tjera të interesuara. Gjatë këtij takimi, ekspertët e TI të projektit ProTax ndanë me të pranishmit funksionalitetet dhe mjetet që i janë shtuar dhe përmirësuar versionit të mëparshëm.

Funksionalitetet kryesore të versionit të ri të sistemit që u prezantuan janë si më poshtë vijon:

- Përmirësim i mëtejshëm i sigurisë për të ruajtur integritetin e të dhënave.
- Funksionalitete të përmirësuara për të manaxhuar regjistrat.
- Shtimi i të dhënave mbi ndërtesat nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- Shtimi i të dhënave mbi tokën nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- Funksionalitete për manaxhimin e taksës mbi tokën, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore".
- Përmirësim i funksionaliteteve të mbledhjes, e cila përfshin në një faturë detyrimet për tokën dhe ndërtesën.

Me ndryshimet e bëra, ky sistem do të jetë gati për taksim dhe lëshim të faturave për të gjitha bashkitë. Kështu që, në përmbushje të kuadrit ligjor në fuqi të gjitha bashkitë inkurajohen të përmirësojnë regjistrat

### Situata aktuale e verifikimit të VKB-ve

Deri tani kanë ardhur në DPTP 32 (tridhjetë e dy) VKB, ndërsa 29 (njëzet e nëntë) bashki nuk i janë përgjigjur kërkesës për dërgimin e informacionit.

Nga 32 (tridhjetë e dy) VKB që kanë ardhur, ka përfunduar analiza e tyre dhe në fund të këtij procesi, DPTP do të dërgojë në mënyrë shkresore komentet dhe sugjerimet për korrigjimet e mundshme për secilën bashki.

Qëndrojmë në pritje të VKB-ve nga bashkitë e tjera.

nëpërmjet verifikimit dhe plotësimit të tyre me qëllim rritjen e cilësisë së taksimit. DPTP do të ofrojë trajnime në lidhje me këtë proces.

Versioni i përmirësuar i sistemit të TI të Kadastrës Fiskale pritet të hidhet në prodhuesion në mes të muajit Mars.


## Statistika për Taksën e Pasurisë

Grafikët më poshtë reflektojnë performancën mbi mbledhjen aktuale të të ardhurave të gjeneruara nga Thesari i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

### Të ardhurat nga taksa e pasurisë

Taksa e pasurisë është një burim i rëndësishëm i të ardhurave vetjake në buxhetin vendor. Të dhënat statistikore për vitin 2021 treguan se të ardhurat nga taksa e pasurisë regjistruan një vlerë rreth **5.67 miliard Lekë**, duke u rritur me rreth **21%** krahasuar me vitin 2020.


Grafiku 1: Ecuria e të ardhurave nga taksa e pasurisë në vite (në miliard Lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)

Të ardhurat nga taksa e pasurisë kanë patur një zhvillim të qëndrueshëm, me ndryshime jo të konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Siç shihet në Grafikon 2, taksa e ndërtesës jep kontributin kryesor në taksën e pasurisë (rreth 80%), duke ruajtur një trend të qëndrueshëm përgjatë viteve. Ndërsa, taksa mbi tokën bujqësore dhe truallin zënë një peshë më të vogël në totalin e të ardhurave nga taksa e pasurisë.

Grafiku 2: Pesha e taksave të pasurisë në 2021




Burimi: MFE

### Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore

Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore në vitin 2021, ndonëse me një peshë më të ulët në krahasim me të ardhurat nga taksa e ndërtesës në totalin e të ardhurave të taksës së pasurisë, kontribuan me rreth 583 milion Lekë (duke pësuar rritje me 7% krahasuar me 2020).


Grafikët e mëposhtëm paraqesin peshën e të ardhurave nga taksa e ndërtesës dhe tokës bujqësore sipas bashkive. Shpërndarja e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore është më e njëtrajtshme midis bashkive, krahasuar me të ardhurat nga taksa e ndërtesës. Kjo e fundit është e përqëndruar në një numër më të vogël bashkish.

Grafiku 3: Pesha e taksës së ndërtesës sipas bashkive (2021)



Burimi: MFE

Grafiku 4: Pesha e taksës së tokës bujqësore sipas bashkive (2021)



Burimi: MFE

Për vitin 2021 niveli më i lartë i të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore është mbledhur nga bashkia Fier (rreth 14%), Lushnjë (rreth 10%) dhe Divjakë (rreth 5%). Duke anashkaluar performancën e bashkive, ky rezultat është i pritshëm si rrjedhojë e karakterit bujqësor të ekonomive të tyre. Ndërsa, përsa i përket taksës së ndërtesës, bashkia Tiranë zë më shumë se 50% të të ardhurave në nivel kombëtar.



Reforma e Taksës së Pasurisë kryhet pjesërisht përmes bashkëpunimit midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencisë Suedeze të Taksave. Bashkëpunimi zhvillohet përmes projektit të quajtur ProTax Albania.

Qëllimi i projektit është **fuqizimi i bashkive duke rritur të ardhurat e tyre vetjake**. Projekti synon administrim modern dhe uniform të taksës së ndërtesës, ku taksimi do të bazohet në vlerën e tregut. Një sistem i qendëruar IT, cilësi e përmirësuar e regjistrave dhe taksapagues të mirë informuar, së bashku me një kuadër ligjor modern pritet ta bëjnë taksimin më të drejtë dhe efikas.

ProTax Albania financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim.



**Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë**  
**Bulevardi Dëshmorët e Kombit  
Nr.3, Tiranë**



**Alvaro.Bulku@financa.gov.al**  
**Klaudia.Vukzaj@financa.gov.al**  
**Valmira.Fejza@financa.gov.al**  
**Eva.Hasa@financa.gov.al**



**<https://dptp.financa.gov.al>**